

Ali M. BASHA

LUFTA E KOSOVËS DHE BASHKËSIA ISLAME

“O ju njerëz që po ju digjen shtëpitë! O ju njerëz që po jua djegim shtëpitë! Nuk e kuptoni, vallë?! Ne duam të mos ktheheni më kurrë, askurrë në këto troje, as në këto anë! Këto të gjitha duhet t'i harroni, thuajse asnjëherë nuk kanë qenë tuajat! Thuajse asnjëherë nuk keni jetuar këtu, as keni ngrënë bukën e kësaj toke dhe as keni pirë këtë ujë!”¹

Kosova ka një territor specifik shumë të lakmueshëm - fusha pjellore, livadhe, kullota, liqene, pyje, basene me rezerva të mëdha qymyrguri, plumb e zink, metale me ngjyrë etj. Janë pikërisht këto pasuri që ndodhen në këtë territor, që kanë nxitur lakmitë e fundamentalizmit ortodoks serb për ta mbajtur atë si një vend kolonial në shekullin XX dhe jo “vendet e shenjta” dhe mitet se Kosova qenka “djepi i Serbisë”.

Konfiguracioni gjeografik i Kosovës bën që territori i saj të ketë një pozitë gjeostrategjike të rrallë në Ballkan dhe në Evropën Juglindore. Kjo pozitë tejet e volitshme, ku kryqëzohen rrugët automobilistike, ajrore dhe detare, të Lindjes dhe të Perëndimit, të Veriut dhe të Jugut të Evropës dhe më gjerë, ka nxitur okupimet e këtyre territoreve që në lashtësinë ilire - nën sundimin romak, më vonë nën sundimin sllavo-bizantin për disa shekuj dhe pas betejës së Fushë-Kosovës qëndroi plot pesë shekuj nën sundimin osman.

Pra, trojet shqiptare në përgjithësi dhe Kosova në veçanti, patën gjatë shekujve një rëndësi të jashtëzakonshme për të gjitha fuqitë potenciale që u shfaqën rreth këtyre trojeve sidomos në mesjetë, por edhe në kohët moderne - mbretërit, sulltanët, diktatorët që donin të dominonin dhe të ruanin influencën e tyre në Gadishullin

e Ballkanit dhe më gjerë, sepse kushdo që zotëronte këto troje, mund të kontrollonte strategjikisht Evropën Lindore. Dhe kjo ishte një nga shkaqet e betejës së Kosovës në vitin 1389 ndërmjet ushtrisë osmane, të prirë nga sulltan Murati I dhe koalicionit ballkanik, të udhëhequr nga knjaz Lllazar Hrebljanoviçi, betejë e cila u përsërit pas 610 vjetësh, pikërisht në kohët moderne të fundshekullit 20-të me drejtim tjetër – midis NATO-s, të udhëhequr prej SHBA-së, nga njëra anë, dhe forcave të diktatorit serb të këtij fundshekulli, S. Millosheviç, nga ana tjetër.

Dëbimet me dhunë të shqiptarëve nga trojet e veta, masakrat, spastrimet etnike e shkatërrimet e monumenteve të kulturës, sidomos të fesë islame, janë bërë në mënyrë të organizuar dhe janë vepër e ideologëve të ndryshëm serbë. Këtë e vërtetojnë të gjitha memorandumet e tyre, ndër të cilat mund të përmendim “Naçartanien” e Grashaninit (1844), duke vazhduar me Çubrolloviçin (1937 - 1944) e deri te memorandumit i Akademisë së Shkencave të Serbisë (1985).

Pse shqiptarët këmbëngulën aq shumë në pavarësi të plotë të Kosovës? Prindërit, vëllezërit, motrat, gruaja, nipërit, mbesat, kushërinjtë, farefisi, shkurt – gjaku (“nuk bëhet ujë” dhe as ujët nuk bëhet gjak), që ka rrjedhur nëpër deje, është i lidhur me një nyje të madhe, me gjuhën shqipe, me shqiptarinë, prandaj, duke qenë i shtrenjtë, si kudo në botë, çmim të vetëm ka lirinë dhe përjetësinë në liri.

Pra, me që liria është gjëja më e shtrenjtë, ajo paguhet me jetë, me jetën e njerëzve më të dashur, me jetën e njerëzve më të shtrenjtë, me sakrificat që nuk kanë asnjë çmim tjetër, përveç atij të lirisë. Gjaku i dëshmorëve është fara e lirisë për brezat që do të vijnë njëri pas tjetrit. Në fakt, ne shqiptarët kemi derdhur gjithmonë gjak për liri, por gjaku i derdhur për lirinë e Kosovës, ishte gjak i derdhur në kohën e duhur dhe në vendin e duhur. Dëshmorët dhe martirët, me varre dhe pa varre, qenia ekonomike dhe kulturore e shkatërruar, si pasojë e strategjisë serbe ndaj tokës shqiptare të djegur, njofton se një betejë u fitua, ndër më të zorshmet, por jo e fundit, lufta, me mjete të tjera, vazhdon dhe do të vazhdojë deri në sendërtimin e plotë të kërkesave që mbrojti Lidhja Shqiptare e Prizrenit, amanet për brezat. Sot Kosova ka UÇK-në, e cila jeton e do të jetojë përjetësisht, e skalitur në lapidare e varre memorialë,

e mbjellë dhe e ujitur me gjakun e kuq të pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Kjo është një fitore lapidar, e cila ka marrë përsipër të qëndrojë në mënyrë të përjetshme kujdestare e sigurisë dhe e ardhmërisë me dinjitet të Kosovës, kujdestare e Pavarësisë së Shpallur me 17 shkurt 2008. Kjo fitore e shqiptarëve të Kosovës, pa mëdyshje, është dhe do të jetë e përjetshme. Këtë përjetësi e paralajmëron dhe e siguron toka e Kosovës, e mbjellë mbarë me lapidarë, përmendore të dëshmorëve e të martirëve me emblemën e UÇK-së, parashenjë treguese se kush e ka sjellë lirinë, kush ia ktheu Kosovës jetën shqiptare.

Kjo është forcë historike dhe kurrë nuk mund të lejojë përdhosje e shkelje të gjakut të lirisë dhe kjo forcë e nderuar dhe e respektuar përgjithmonë, përulet në shenjë nderimi e betimi para këtyre monumenteve të trimërisë, të burrërisë e të sakrificës së dëshmorëve, të martirëve të kombit, të luftës që solli lirinë dhe në mënyrë të pandalshme, eci drejt Pavarësisë së Kosovës.

Ekziston një përvojë e hidhur në lidhje me autonominë e Kosovës. Edhe pse *de jure* ka ekzistuar njëlloj autonomie, *de facto* shqiptarët kanë pasur çelësat e kashtës në dorë, gjithçka përgatitej e administrohej nga Beogradi – autonomi formale pa asnjë garanci, fytyra e vërtetë e së cilës u shfaq brenda një nate, kur S. Millosheviçi, me një të rënë të lapsit, e shoi nga defteri. A i respektuan serbët garancitë dhe marrëveshjet e mëhershme, apo të fundit, ato që dolën nga Dejtoni? A arriti Perëndimi ndonjëherë t'i vinte në jetë të gjitha marrëveshjet e Dejtonit?

Duhet evidentuar se nuk ka ekzistuar asnjë element i përbashkët – gjuha, feja, tradita janë të ndryshme. Popujve të tjerë që e përbënin ish-Jugosllavinë si Sllovenia, Maqedonia etj., që kanë pasur elementë të përbashkët, iu lejua me kohë Shpallja e Pavarësisë, ndërsa Kosovës iu mohua deri në fund me çdo mjet të dhunshëm. Rezistenca e popullit kosovar dhe thyerja e saj, me hekur e zjarr, megjithëse e përkohshme, janë karakteristikat e shekullit të 20-të, sidomos të gjysmës së dytë të tij. Kosova e kishte kuptuar me kohë se nuk mund të qëndronte kurrë më nën Serbinë apo me të. Për Kosovën zgjidhja e vetme ishte Pavarësia. Populli kosovar u nis i bindur plotësisht drejt fitores, prandaj patjetër do ta arrinte atë që meritonte, Shpalljen e Pavarësisë. Ja, pra, pse shqiptarët këmbëngulën aq shumë për Pavarësi.

Shpërthimi i programuar i revoltës së studentëve në mensën e Qendrës Studentore me 11 mars 1981, shërbeu si detonator faktik për t'i dhënë flakë energjisë revolucionare nacionalçlirimtare të akumuluar në vijimësi, gjatë gjithë shekullit të 20-të. Ky zjarr e kjo lëvizje qenë trashur para viteve 60-të dhe vazhduan të rriten e të thellohen në ndërgjegjen patriotike dhe revolucionare të rinisë shkollore, studentore, punëtore, qytetare e fshatare dhe të masave të tjera shqiptare, të ndodhura nën robërinë jugosllave. Mesazhin e këtij fenomeni shoqëror shqiptar pushtuesit jugosllavë e kishin marrë me kohë, por do t'u bëhej shumë i qartë, do ta kuptonin mirë me 26 mars 1981, kur studentët vërshuan nëpër rrugët e sheshet e Prishtinës, të përshëndetur e përkrahur fuqimisht nga të gjitha strukturat e shoqërisë në mbarë vendet ku gjenden shqiptarë.

Dhuna e policisë speciale jugosllave mbi studentët e studentet në rrugët e Prishtinës dhe në konvikte, për të fikur fenerin ndriçues liridashës me dhunën shoviniste pushtuese serbe, solli shpërthimin e demonstratave, ku u përfshi gjithë populli shqiptar në fillim të prillit 1981, demonstrata të cilat, në seancat e përgjakshme të hetuesisë politike, u quajtën pa ndrojtje nga të burgosurit politikë si "Pranvera shqiptare '81". Dhe mbi gjakun e freskët të dëshmorëve të "Pranverës Shqiptare '81" u ngrit lëvizja ilegale politike e luftarake e viteve '80-të dhe rezistenca shqiptare legale si lëvizje kombëtare demokratike; u ngrit Lëvizja e Pajtimit Kombëtar përmes faljeve të hasmërive nga 2 shkurti 1990, deri në 17 maj 1992 dhe mbi tabanin e kësaj lëvizjeje u ngrit Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja), e cila, me pushkë, me penë, me mendim politik e diplomatik për pesë vjet të Luftës guerile dhe, duke filluar nga 26 nëntori i vitit 1997, për një vit, gjashtë muaj e pesëdhjetë ditë të luftës, ballë për ballë me forcat speciale, soldateskën dhe ushtrinë e Millosheviçit deri më 12 qershor 1999, e ndihmuar vendosmërisht, drejtpërsëdrejti nga forcat e NATO-s, të udhëhequra nga SHBA-ja, e dërgoi popullin e Kosovës në lirinë që po gëzon sot dhe, gradualisht, në Shpalljen e Pavarësisë, e cila pas çdo dite gëzon përherë e më tepër njohje ndërkombëtare.

Nëse do të hulumtonim në kronologjinë mediatike të ngjarjeve që i dhanë popullit të Kosovës lirinë, atëherë ndër to mund të evidentonim: Në vitin 1996 kemi atentatet dhe goditjet e para të armatosura ndaj postave e policëve serbë. Në nëntor 1997

gjatë një ceremonie varrimi të disa shqiptarëve etnikë, të vrarë nga policia serbe, shfaqen për herë të parë në publik anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ushtri që edhe më parë kishte marrë përsipër sulme të armatosura kundër policisë serbe. Në mars 1998 zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe Ibrahim Rugova rizgjidhet president i Kosovës. Serbia mban qëndrim radikal duke i deklaruar zgjedhjet të jashtëligjshme, të pavlefshme. Në maj të vitit 1998 nën mbikëqyrjen ndërkombëtare zhvillohen takimet e para ndërmjet Rugovës e Millosheviçit. Në korrik të vitit 1998 UÇK-ja deklaron se ka nën kontroll 40 % të territorit të Kosovës. Ndërkohë, autoritetet ushtarake serbe fillojnë një ofensivë të re në stil të gjerë kundër UÇK-së, e cila shoqërohet me një valë spastrimi etnik, ku mbi 20 mijë kosovarë kalojnë kufirin shqiptar në rrethin e Tropojës. Më 24 shtator 1998 NATO-ja i dërgon ultimatum Serbisë për të ndaluar dhunën ndaj civilëve të pafajshëm dhe kërkon armëpushim. Ndërkohë Grupi i Kontaktit urdhëron palët – serbët e shqiptarët, të fillojnë bisedimet, që u caktuan të mbahen në Rambuje të Francës në shkurt të vitit 1999. Pas gati një pushimi dyjavor, delegacioni shqiptar firmos marrëveshjen e Rambujesë, ndërsa delegacioni i Serbisë refuzoi. Pas ultimatumit të NATO-s dhe refuzimit të përsëritur të Serbisë për ta firmosur marrëveshjen, fillon aksioni i bombardimeve ajrore të Aleancës së Atlantikut mbi objektivat ushtarake strategjike serbe në vetë Serbinë, në Mal të Zi e Kosovë.

Bombardimi ajror i forcave të NATO-s mbi ish-Jugosllavinë u shoqërua me një gjenocid e racizëm të ashpër ndaj shqiptarëve etnikë të ushtruar nga ushtria, policia dhe paraushtarakët serbë. Millosheviçi, bombardimeve iu kundërpërgjigj me një spastrim të paparë etnik, që u shoqërua me masakra e përdhunime kolektive ndër më makabret mbi popullsinë civile të pambrojtur shqiptare. Beogradi ndoqi strategjinë e tokës së djegur dhe shpopullimin e krejt territorit kosovar nga shqiptarët etnikë. Ky gjenocid u realizua mbi bazën e një plani të mirëpërcaktuar nga Beogradi shumë kohë përpara, i mbiemëruar “Operacioni patkoi”. Vendet ku u zhvilluan masakrat e tmerrshme të këtij operacioni ishin Likoshani, Qirezi, Dukagjini, Raçaku, Krusha e madhe . . . e gjithë Kosova.

Falja bën pjesë në dispozitat fetare, por të harrosh apo të mohosh përpjekjet e kaluara, vuajtjet, masakrat, rezistencën, gjakun e

dëshmorëve, të martirëve, të pleqve, të fëmijëve, përdhunimet, kudo që të kenë ndodhë, në ndonjë kënd të botës, nuk është tjetër veçse mohim i ekzistencës aktuale dhe varrosje e të ardhmes me mjete legale.

Për çështjen e përbashkët të popullit e të kombit kërkohen sakrifica kolektive. Numri i madh i dëshmorëve të çdo vendi apo populli, është dëshmi e qartë se atij populli apo atij vendi i ka munguar liria dhe se ai popull atë e ka vlerësuar me çdo çmim. Luigj Gurakuqi, atdhetar i shquar i Rilindjes së kombit tonë ka thënë: “Një popull që nderon burrat e vet, një popull që pavdekëson qëndrimin e tyre, jo vetëm ndër faqet e historisë, por edhe mbi rrasa e monumente, ai popull tregon se ka ndërgjegje, se ka ndjesi të holla”.

Këtij spastrimi nuk mund t’i shpëtonin dhe nuk i shpëtuan jo vetëm vendbanimet e shqiptarëve, por as institucionet e zyrat e gjendjes civile, objektet e kultit të fesë myslimane si dhe objekte të tjera publike – shkolla, qendra shëndetësore etj. Përveç spastrimit etnik, me veprimet e veta, Serbia synoi të zhdukë identitetin e shqiptarëve të Kosovës. Krahas djegies së shtëpive, forcat serbe ndërmorën veprime barbare të papara, duke djegur të gjitha zyrat, kadastrat e arkivat e qyteteve, të fshatrave dhe të komunave. Ata u merrnin kosovarëve në kufi pasaportat, patentat, lejet e qarkullimit e targat e makinave dhe çdo dokument tjetër identifikimi, përfshi të hollat që mund të kishin.

Në lidhje me çështjen e Kosovës edhe më parë, por veçanërisht gjatë Luftës, është përdorur shumë togfjalëshi “Kisha Ortodokse Serbe”. Në fakt, kjo kishë ka qenë shumë aktive gjatë tërë historisë dhe këtë e shfaqte herë brenda kuadrit të teologjisë ortodokse, por më shpesh në rrafshin religjioz-nacional, natyrisht me bekimin e Rusisë dhe të shteteve të tjera ortodokse. Këto komponentë u aktivizuan shumë gjatë shekullit të 20-të, sidomos në Kongresin pansllav, të mbajtur në Beograd më 1946. Kisha Ortodokse Serbe ka zhvilluar aktivitete të një intensiteti të lartë, sidomos, gjatë viteve ’90 të shekullit të kaluar. Qëndrimi i saj antishqiptar në krah të forcave serbe të Millosheviçit është konfirmuar publikisht e zyrtarisht, por në këtë shkrim do të theksojmë sadopak rolin e bashkësisë islame të Kosovës në çështjen e çlirimit të saj.

Pas ndryshimeve të mëdha dhe krijimit të rrethanave të reja në ish-Jugosllavinë, veçanërisht në Kosovë, në fillim të viteve '90-të, Bashkësia islame e Kosovës shpalli pavarësinë e vet (1993), duke i paraprirë kështu Shpalljes së Pavarësisë së shtetit të Kosovës (2008).

Kjo bashkësi ka qenë dhe është një institucion ekzekutiv i Kuvendit të Bashkësisë islame të Kosovës që mbikëqyr 21 qendra islame në gjithë Kosovën, administron Fakultetin e Studimeve Islame, medresenë e mesme "Alaud' din" me degët e veta, mbikëqyr xhamitë e shpërndara në gjithë territorin e Kosovës. Mundohet që me forcat e veta, të ofrojë gjithçka që posedon në lëmin humanitar dhe, përveç kësaj, këshillon e udhëzon banorët për të ndjekur rrugën e mirë, i nxit të jenë të fortë, të durueshëm në përballimin me armikun shekullor. Në kumtesën e saj kjo bashkësi, në ato kohë të vështira, ka bërë këtë deklaratë: "Megjithë insistimet tona disavjeçare që çështja e Kosovës të zgjidhet në mënyrë paqësore, sidomos nga shkurt-marsi i këtij viti e deri më sot, soldateska serbe bëri dhe vazhdon të bëjë gjenocid, spastrim etnik, plaçkit fshatra të tëra e më pas u fut flakën për të mbuluar krimet e veta primitive. . . Kryesia e Bashkësisë islame është e angazhuar që opinionin ndërkombëtar, e sidomos atë islam, ta njoftojë vazhdimisht për atë që po ndodh në Kosovë".² Ka qenë pikërisht kjo politikë që ka shkaktuar kjo bashkësi, që shumë punonjës të saj t'u nënshtrohen arrestimeve, pyetjeve informative, dënimeve, dhunimeve dhe keqtrajttimeve nga më të ndryshmet, deri në ekzekutime pa gjyq.

Bashkësia islame ka qenë dhe është plotësisht e hapur ndaj të jashtmes dhe të brendshmes. Hapja e jashtme diktohet nga marrëdhëniet me institucionet dhe organizatat e shoqërisë dhe të shtetit, ndërsa hapja ndaj së brendshmes konstatohet në lirinë e komunikimit me opsione të ndryshme të shpjegimit të fesë islame, prej të cilave ka që janë plotësisht të reja në përvojën tonë shqiptare. Për këtë arsye, me të drejtë shtrohet pyetja nëse është e drejtë të hapen krejtësisht dyert dhe dritaret e institucioneve tona islame. Ato le të hapen në funksion të përballimit të situatave, madje këtë e kërkon koha dhe duhet të jemi të përgatitur, por Bashkësia islame

duhet të jetë gjithmonë syçelë, sepse mund të depërtojnë politika jo të përshtatshme për vendin, madje ka prej tyre që rrezikojnë tolerancën që shqiptarët e kanë trashëgim nga të parët dhe, ç'është edhe më e keqja, vë në rrezik çështjen kombëtare. Në këtë drejtim Bashkësia islame e ka për detyrë të sqarojë të gjithë studentët që kanë mbaruar jashtë vendit dhe t'i ambientojë me traditën tonë të trashëguar, e cila ka përballuar shumë rrebeshe në drejtim të fesë islame.

Natyrisht, kritika serioze, e cila rregullon gjërat e trajtuara jo drejt në shoqërinë tonë, jo vetëm që është e mirëpritur, por edhe e nevojshme. Ndërsa urrejtja është gjykim për secilin. Kritikant tendencioze që bëhen ndaj besimeve fetare, besimtarët i konsiderojnë si mbeturina nga e kaluara kur ateizmi ishte në pushtet, që realizohen nga njerëzit, të cilëve mësimet e marksizëm-leninizmit u janë bërë pjesë e mentalitetit.

Ka shumë rëndësi që të zhvillohet ndjenja e respektit ndaj besimit fetar në përgjithësi dhe të tjetrit, në veçanti, jo vetëm në kuptimin e durimit, domethënë të tolerancës, por në kuptimin e njohjes dhe të pranimit të asaj që të tjerët kanë të drejtë ta kenë dhe të jenë ata që janë në besimin e tyre fetar, si dhe në mënyrën se si ata e interpretojnë atë.

Sidoqoftë, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në kritikant që na bëhen, jo sepse ato i ka thënë dikush, por sepse islami ka një rregull, që ka rëndësi në çdo drejtim: Kudo duhet të jemi të matur. Ka një ajet në Kuranin famëlartë që thotë: "Kur të faleni që të manifestoni besimin tuaj fetar, mos e ngrini zërin lart, as mos e ulni, por përmbahuni sipas mjedisit". Ky duhet të jetë rregulli ynë, jo se dikush na kritikon p.sh. për ezanin se thërritet me zë shumë të lartë, por sepse mjedisi publik që përdorim është edhe yni, por edhe i të tjerëve. Zgjidhja gjendet duke respektuar lirinë e tjetrit.

Përderisa të mos kuptohet se problemi që ka tjetri është edhe i imi, p.sh. robëria e tjetrit është mungesë lirie edhe për mua, do të jemi të dobët përballë sfidave personale dhe të drejtës së përgjithshme për liri. Për këtë duhet të dimë se, po të na jepet rasti të zgjedhim ndërmjet një besimtari që nuk është i aftë për të mirën e përgjithshme dhe një më pak besimtari, por që është i aftë për të mirën e përgjithshme, duhet të zgjedhim atë që është i

aftë për të mirën e përgjithshme, sepse është përfitim për të gjithë dhe dëm i një njeriu, ndërsa i paafiti për të mirën e përgjithshme mund t' u sjellë dëm të gjithëve.

Duhet realizuar ajo që është detyrë - mbrojtja në mënyrë të vazhdueshme e vlerave islame. Është kënaqësi kur je i lirë dhe se mund të vetëpërcaktohesh, pa marrë parasysh se ç' mendojnë të tjerët për Islamin, i cili është besimi i dialogut dhe jo i tëhuajimit - besimi i tolerancës dhe jo besimi i poshtërimit.

Kur bëhet fjalë për qëllimet dhe format organizative të bashkësisë islame dhe të shtetit, atëherë duhet evidentuar se qëllimi i bashkësisë islame është të promovojë vlerat e islamit, ndërsa forma e saj e organizimit duhet të plotësojë kërkesat e myslimanëve. Qëllimi i shtetit është t' u sigurojë paqe dhe siguri shtetasve, ndërsa forma e tij e organizimit duhet të plotësojë kërkesat e të gjithë shtetasve, përfshirë edhe myslimanët si shtetas. Prandaj është normale që bashkësia islame të luftojë që të sendërtojë qëllimet e veta nëpërmjet formave të organizimit, ndërsa shteti qëllimet e tij. Por, nganjëherë, këto qëllime sendërtohen veças, nganjëherë me përpjekje të përbashkëta. Do të ishte e drejtë që secili, shteti dhe bashkësia islame, të bëjë punën e vet. Që shteti të sigurojë kushtet për punë të organizuar të bashkësive fetare, nuk është nevoja që të marrë përgjegjësitë e tyre, sikurse edhe bashkësitë islame nuk mund të marrin mbi vete rolin e shtetit. Nëse fjala është për ndarjen e shtetit nga besimet fetare, atëherë sigurisht kjo ndarje është e drejtë. Po kështu duhet të veprohet edhe me organizatat humanitare, të cilat nganjëherë e vënë veten në rolin e konkurruesit të bashkësisë islame, e cila, natyrisht, duhet të jetë e pranishme dhe vepruese atje ku pritet që të organizohet puna, duke marrë përsipër përgjegjësitë e veta.

Bashkësia islame e Kosovës është treguar aktive në angazhimin për kultivimin në shkallën më të lartë të tolerancës fetare dhe ndërfitare në jetën e njerëzve. Drejtuesit e UÇK-së kanë qenë shumë të interesuar e të kënaqur për ekzistencën në Kosovë të një kleri, i cili gjatë Luftës u pozicionua drejt, ndaj çështjes dhe interesit kombëtar. Kur besimtarët shikojnë së bashku myslimanët e katolikët, jo vetëm në takime por edhe në veprime për çështjen kombëtare, edhe ata, natyrisht, do të jenë së bashku. Në periudhën që kalon Kosova, ka qenë fat që ka pasur klerikë të arsimuar edhe

me kulturë të përgjithshme, të cilët i kuptojnë drejt situatat, dinë se çfarë kërkojnë dhe flasin me një zë të unifikuar. Në periudhën kur Kosova ka pasur më tepër se kurrë nevojë për njerëzit e vet, ata qenë në dispozicion të saj. Kjo bashkësi ka treguar angazhim për ruajtjen e pastërtisë së fesë islame, pa e ndarë vetëdijen fetare nga ajo kombëtare. Ajo ka treguar, gjithashtu, angazhim për pajtimin kombëtar, i cili është konsideruar si njëri nga detyrimet kryesore të kësaj bashkësie, para dhe gjatë Luftës së Kosovës. Kanë qenë prijësit fetarë, ata që shkonin në ballë për pajtimin kombëtar të kosovarëve, duke përgatitur terrenin për veprime të tilla si falje gjaqesh, grindje, mërina etj. Ata ishin pranë popullit kur ndodhte fatkeqësia për të dhënë kurajë se edhe për popullin e Kosovës, me shpresë të Zotit, do të vinin ditë të bardha. Angazhimi i prijësve fetarë për ngritje morale dhe zhvillim kulturor, si kusht për zhvillimin e virtyteve dhe të vlerave të përgjithshme, ka qenë një fushë tjetër ku janë aktivizuar me predikimet e veta prijësit e fesë islame.

Bashkësia islame, me veprimet e realizuara, ndryshoi për të mirë opinionet ndaj disa klerikëve myslimanë, të formuara qoftë si pasojë e ndikimit të doktrinave ideologjike apo të vetë fuqisë ndikuese të tyre për shkak të nivelit të ulët arsimor që kanë pasur disa nga këta hoxhallarë. Ndër qytetarët e Kosovës bëri që të rikthehej respekti për prijësit islamë, veçanërisht për ata me arsim të lartë që shërbenin në Kosovë. Çdo njeri lind me ndjenja të pastra, me ndjenja islame, të cilat do t'i kultivojë varësisht nga edukata e prindit, nga rrethi shoqëror, nga ambienti dhe nga aktiviteti i njeriut. Se sa janë të kultivuara dhe të ngritura këto ndjenja fetare, është çështje tjetër. Mirëpo afrimi i njerëzve në drejtim të fesë ka pasur më tepër rezultat tek ata individë që i kanë pasur pothuajse të formuara bindjet e qëndrimet e veta. Për të tjerët, shkakun mund ta kërkojmë në mosinformimin e tyre në shkallën e duhur, në propagandën antifetare ose në faktorë të tjerë. Por, për fat të mirë, ndryshimet e realizuara pas dekadash të tëra, mundësuat që shumë të rinj dhe intelektualë ta shikojnë me sy kritik edhe çështjen e mësimave fetare; ata po shfaqin interes për të gjitha problemet fetare, kështu që duan të njihen me të vërtetën dhe ta kuptojnë të vërtetën se cili ka qenë "opiumi për popullin". Këtë zbrazësi për mësimet e fesë janë përpjekur ta mbushin predikuesit

fetarë me interpretimet e tyre të qarta, pavarësisht presionit të ushtruar mbi ta.

Për ta kuptuar më drejt qëndrimin dhe persekutimin, që iu bë institucionit të Bashkësisë Islame, kuadrove dhe vlerave të saj, le t'i rikthehemi edhe njëherë asaj që ndodhi në Kosovë gjatë viteve 1997-1998. Siç e kemi theksuar, u realizua një pastrim etnik në mbarë popullatën shqiptare, me qëllimin e vetëm të zhdukjes së identitetit; masakra të njëpasnjëshme, për të zgjidhur njëherë e mirë, sipas tyre, çështjen e Kosovës. Për këtë, e gjithë pakica serbe në Kosovë, e cila përbën vetëm 5 % të popullsisë së Kosovës, u armatos nga ushtria serbe, madje haptazi, në prani të qytetarëve. Të rinjtë serbë ushtronin dhunë fiziko-psikologjike ndaj qytetarëve të pafajshëm shqiptarë, duke i dëbuar nga shtëpitë për t'i zënë ato me kolonë serbë - pak a shumë, një Bosnje e dytë. Numri i të burgosurve politikë deri në mesin e prillit të vitit 1998 arriti në më tepër se 12 mijë vetë dhe të larguarit nga puna në mbi 150 mijë. U mbyllën të gjitha shkollat në gjuhën shqipe, përfshi Universitetin; Akademia e Shkencave pushoi veprimtarinë e vet, u ndalua Radio-televizioni në gjuhën shqipe. Mbi gjysmë milioni shqiptarë të Kosovës emigruan në vendet e botës perëndimore. Kosova u paralizua komplet.

Dhuna e shfrenuar serbe ndaj shqiptarëve erdhi duke u fryrë si një kodër vullkani që prej vitit 1989, kur me dhunë u pezullua autonomia e Kosovës, me të gjitha organet dhe institutet e tjera legjitime, për të shpërthyer me tërë forcën vrastare në vitet 1998-1999, kur planet e mëhershme filluan të zbatoheshin për zhdukjen e shfarosjen kolektive të një populli të tërë.

Mbi 12 mijë të vrarë e të masakruar, shumica gra, pleq e fëmijë, qindra e mijëra gra të dhunuara, mijëra njerëz të zhdukur e të burgosur - bilanci tragjik i një politike shoviniste që e udhëhoqi regjimi serb, i përkrahur, fatkeqësisht, jo vetëm nga Kisha Ortodokse, por edhe nga popullata lokale serbe e Kosovës, e cila u përpunua në mënyrë të tillë sa që, pas demonstratave të vitit 1981 nuk desh të dinte për tolerancë, fqinjësi e vullnet të mirë.

Për t'i ilustruar më saktë këto, po u rikthehemi kronikave të atyre kohëve shumë të vështira: Në mars 1999 në Teqenë e Madhe të Gjakovës, ku ishin strehuar qindra vetë, forcat serbe u futën dhe keqtrajtuan të strehuarit, duke veçuar nja 50 burra, të cilët, pasi

i rrahën barbarisht, i nisën në drejtim të paditur. Në maj të vitit 1999 marrim vesh se një dëshmitar kishte humbur gruan bashkë me 4 fëmijët. Ai tregon se zjarri në qytet ka filluar me djegien e 4 shtëpive të imamëve të xhamive dhe, pas një ore, u dogj xhamia e Zallit dhe xhamia e Ibrit. Po sipas kësaj kronike, marrim vesh nga një 60-vjeçare nga fshati Bellanicë, komuna e Suharekës se ushtarët serbë dogjën fshatin dhe therën me bajoneta dhjetëra fshatarë, ndërsa imamit të xhamisë së fshatit i prenë të dy këmbët dhe e lanë ashtu të masakruar derisa vdiq nga gjakderdhja. Në qytetin e Mitrovicës janë identifikuar mbi 500 të vrarë, janë dëbuar mbi 50 mijë banorë të Mitrovicës, duke i detyruar të shkojnë në Shqipëri, Maqedoni dhe vendet perëndimore. Atje u shkatërruan plotësisht xhamitë e famshme, si xhamia 400-vjeçare e Ibrit, që u kthye në hi e shkumb nga paramilitarë serbë. Në oborrin e saj u masakruan drejtuesit e xhamisë, si dhe 30 djem të rinj nga komuna e Mitrovicës. Në mars të vitit 1999, njoftohej për mbi 80 të vrarë të hedhur në një rën nga xhamitë e Gjakovës; për koka të prera dhe gjymtyrë të hedhura nëpër rrugë, njerëz të masakruar dhe femra të përdhunuar para syve të fëmijëve të tyre; në Pejë janë goditur me artileri të rëndë nga ushtria serbe dhe më pas janë shkatërruar tri xhami monumentale. Agjencitë e lajmeve njoftojnë mbylljen e medreseve në Prishtinë, në Prizren dhe në Gjilan; policia po vret imamët, që u kanë falë xhenazën shqiptarëve viktimat. Në mars të vitit 1999, sipas agjencive të lajmeve kishte arritur në 1 milion numri i të shpërngulurve nga shtëpitë e tyre në Kosovë dhe shumë prej atyre që nuk kanë mundur të kalojnë kufirin me shtetet fqinjë, jetonin pyjeve, kodrave e maleve, pa mjete jetese. Bashkimi evropian shprehej se mund të evakuonte me anë të ajrit 100 mijë persona, nga ata që ishin strehuar në Shqipëri. Qeveria e SHBA-së deklaronte se mund të priste 20 mijë kosovarë, Turqia gjithashtu. Gjermania u tregua e gatshme të jepte asistencë humanitare për rreth 70 mijë të dëbuar kosovarë që ndodheshin të bllokuar në kufirin maqedonas, si dhe të presë 10 mijë vetë prej tyre në vendin e vet. Shoqata të ndryshme humanitare, veçanërisht ato të vendeve myslimane e ngritën në nivelin më të lartë veprimtarinë e tyre humanitare në ndihmë të refugjatëve të strehuar në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi etj.³

detyruar me forcë t'i braktiste vatrat e të parëve, filloi të kthehej me një shpejtësi marramendëse. Ky kthim, i madh dhe aq i shpejtë, habiti botën. Banorët ngritën tendat buzë gërmadhëve-shtëpi, në oborret e shkretuara, të lumtur që arritën të riktheheshin në vatrat e të parëve. Por plagët e Kosovës qenë jashtëzakonisht të rënda – qindra varreza masive anekënd saj të kujtonin mynxyrat dhe vuajtjet e një lufte të tmerrshme, të pabarabartë, e cila ishte drejtuar kryesisht kundër civilëve të pambrojtur, mijëra të zhdukur, fati i të cilëve ende, megjithë interesimin e treguar, nuk dihet.

Agresioni policor, ushtarak e paramilitar serb në Kosovë nuk rrezikoi vetëm jetën e mbi 2 milion shqiptarëve autoktonë, por shkaktoi rrënimin, djegien dhe shkatërrimin e një numri të madh të objekteve kulturore dhe fetare. Agresorët serbë duke shkatërruar me vetëdije dhe me plan tërë atë që ishte ndërtuar gjatë shekujve në truallin e Kosovës – trashëgiminë e saj kulturore, shkaktuan dëme të pakompensueshme.

Sikurse e përmendëm, gjatë ekspeditës kriminale serbe, nuk u kursyen as objektet me vlera të larta të arkitekturës dhe të qytetërimit islam në Kosovë, siç janë xhamia e Hadumit në Gjakovë, e ndërtuar para 400 vjetësh, çarshia e vjetër dhe biblioteka e xhamisë, e themeluar me 1592/5, me qindra dorëshkrime të vjetra orientale; Xhamia e Llapit e Prishtinës, e ndërtuar me 1470, selia e Kryesisë së bashkësisë islame të Kosovës në Prishtinë, e cila është djegur ditën kur në Prishtinë hynë forcat e NATO-s. Aty u dogjën Arkivi i bashkësisë islame dhe shumë dorëshkrime të tjera me vlerë të madhe. Në qytetin e Pejës me rrethinë, pothuajse janë djegur të gjitha xhamitë, si e Çarshisë (1470), e Kurshumlisë (1577), e Defterdarit (1570), e Hamamit (1587), xhamia e Kuqe (1755). Pjesa më e madhe e institucioneve të fesë islame që u dogjën, kanë qenë nën mbrojtjen e Institutit për mbrojtjen e monumenteve historike.

Djegia dhe rrënimi i objekteve të arkitekturës islame nga ana e serbëve, është vazhdimi i veprimtarisë kulturocidit ndaj pjesëtarëve të besimit islam në Ballkan. Në të ashtuquajturin "Kanuni i Vasojeviçit" (pjesa e parë e shekullit të 19-të) në njërën prej dispozitave të tij, inkurajohet dhe legalizohet shkatërrimi i veprave të kulturës islame. Kjo tendencë barbare është e pranishme në të gjitha programet e organizatave nacionaliste serbe. Kështu,

vepra me vlera të larta të arkitekturës islame janë zhdukur nga faqja e dheut si rezultat i politikës sistematike të gjenocidit kulturocid serb gjatë historisë mbi njëqindvjeçare. Me këtë rast mund të përmendim se si pasojë e politikës së kahershme antiislame të serbëve, në Pashallëkun e Beogradit ka pasur më shumë se 600 xhami, prej të cilave sot ka mbetur vetëm Bajrakli, xhamia në Beograd.

Kosova dhe përgjithësisht hapësira shqiptare jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, ka qenë objekt përpjekjesh të vazhdueshme të fqinjëve për të zhdukur çdo gjurmë të karakterit shqiptar. Intensiteti i këtyre përpjekjeve ka qenë i ndryshëm dhe ka arritur kulmin në dhjetë vjetët e fundit, sidomos në pjesën e parë të vitit 1999, kur Serbia ndërmoi fushatën e egër për zhdukjen e çdo gjëje që ka qenë shqiptare dhe për ndryshimin e karakterit shqiptar dhe jo ortodoks të këtyre trojeve. Në këto fushata kundër shqiptarëve të Kosovës, objekt kryesor i sulmeve kanë qenë xhamitë të cilat, sikurse edhe kishat e sinagogat, njerëzit i përdorin si faltore, por që shpeshherë kanë shërbyer edhe për përmbushjen e funksioneve të tjera shoqërore si: qendra shkollore për mësim, biblioteka, bujtina të përkohshme për të pastrehët dhe deri spitale. Kështu p.sh. vetëm gjatë tre muajve (mars - qershor 1999) forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbë dogjën, rrënuan ose granatuan 218 xhami, disa prej të cilave kishin vlera të jashtëzakonshme historike dhe kulturore si, xhamia e Çarshisë në Pejë, në oborrin e së cilës janë varrosur dy prijësit e shquar të Lëvizjes shqiptare: Haxhi Zeka dhe Ali pashë Guxia; janë zhdukur tërësisht monumente me rëndësi të veçantë historike, si monumenti i Lidhjes së Prizrenit, kulla e Haxhi Zekës, ku është mbajtur Kuvendi i Lidhjes së Pejës; janë shkatërruar me dhjetëra shkolla, biblioteka, fonde të dokumenteve e librave orientale etj. Kur u bë bilanci tragjik që lanë pas hordhitë barbare Millosheviçiane prej 560 xhamive që kishte gjithsej Kosova para luftës, 218 u dogjën, u shkatërruan apo u dëmtuan rëndë. U dogjën dhe u shkatërruan nga themeli 4 medrese, ndërsa u dëmtuan rëndë objekti i ri, medreseja "Alaud' din" në Prishtinë; u dogjën dhe u dëmtuan 3 teqe, 1 hamam, 75 dyqane pronë të vakëfit, u dogjën apo u shkatërruan 302 shtëpi të imamëve. Nga dora gjakatare serbe u vranë 16 imamë, 1 punonjës i administratës së bashkësisë islame dhe 14 nxënës të medrese së mesme "Alaud' din"

të Prishtinës.

Si pasojë e djegies dhe e shkatërrimit të xhamive, si dhe objekteve të tjera të fesë islame, pati dëme të pakompensueshme edhe në simbolet e shenjta islame. Kështu, u shkatërruan 86 minare, 117 mihrabë, 120 hytbe, 114 kupola, mbi 560 arabeska origjinale të artistëve shqiptarë, madje një pjesë prej tyre ishin të vjetra edhe me shekuj, mbi 12 mijë mus'hafe e dorëshkrime të vlefshme për vjetërsinë e tyre; këtyre u duhen shtuar edhe materialet arkivore dhe sendet e tjera të ruajtura në arkivin e bashkësisë islame të Kosovës dhe e gjitha kjo që një humbje e madhe jo vetëm për të kaluarën historiko-kulturore të Kosovës, por edhe për qytetërimin botëror.

Djergia dhe shkatërrimi i monumenteve të kulturës historike, është një fenomen që rregullisht u prin tragjedi të mëdha njerëzore, shkon paralel me to ose i pason. Në rastin e parë, shkatërrimi i monumenteve të kulturës ka për qëllim të fshijë kujtesën e një populli, të një grupi kombëtar, fetar ose të ndonjë grupi tjetër, të fshijë identitetin e tij të veçantë dhe kështu, të hapë rrugën apo të lehtësojë asimilimin e tij brenda grupit dominues; në rastin e dytë, shkon paralelisht me zhdukjen masive të njerëzve me gjenocid ose me spastrime etnike, që rregullisht lidhen me luftën dhe pushtimet; në rastin e tretë, zhdukja e monumenteve kulturore-historike është në funksion të zhdukjes së argumenteve mbi karakterin e ndryshëm të një territori, të një populli, të një grupi racor, etnik, fetar apo të ndonjë grupi tjetër.

Nëse fenomenin e luftës do ta shikojmë historikisht, ajo nuk është përjashtuar nga jeta ndërkombëtare, pavarësisht se është klasifikuar si një nga të këqijat që sjell krimet më të mëdha, që pllakosin njerëzimin. E drejta humanitare, si pjesë e rëndësishme e së drejtës ndërkombëtare, është përpjekur shumë që t'i kufizojë të drejtat e palëve në konflikt për të mos përdorur metodat dhe mjetet sipas zgjedhjes së tyre, me qëllim që të mbrohen personat dhe prona që mund të preket nga konflikti. Prandaj e drejta humanitare ndërkombëtare konsiderohet si instrument i rëndësishëm për ndalimin e përdorimit irracional të forcës ndaj viktimave të luftës. Zakonet dhe ligjet e luftës përcaktojnë që palët ndërluftuese të mos kenë të drejta të zgjedhin në mënyrë të pakufizuar mjetet për sulm ndaj armikut. Ato i detyrojnë shtetet në luftë që të

vetëpërbahen nga përdorimi i disa lloje armësh (helmuese, kimike, bakteriologjike, napalm etj.), prej disa veprimeve të pandershme apo nga sulmi ndaj disa objekteve. Kështu, ndalohet përdorimi i forcës ndaj personave që nuk marrin pjesë në luftë apo nuk janë të aftë për të luftuar (klerikët e feve të ndryshme, civilët, gratë, fëmijët, pleqtë, të sëmurët, të plagosurit, ata që kanë dorëzuar armët apo që nuk janë të aftë për t'u mbrojtur etj.). Ato ndalojnë, gjithashtu, veprimet luftarake ndaj objekteve të caktuara fetare, historike, kulturore, shëndetësore, humanitare etj.

Por është pranuar botërisht se serbët këto lloj ndalimesh me akte ndërkombëtare, i paskan pranuar dhe firmosur formalisht, se jo vetëm që nuk i kanë respektuar marrëveshjet në fjalë, por nuk kanë respektuar edhe veprimet që vetë qeveria e ish-Jugosllavisë ka dënuar me deklarata para fillimit të luftërave në ish-Jugosllavi, veprime që i kanë realizuar regjimet diktatoriale. Nga kjo vetvetiu arrihet në konkluzion se, serbët gjithçka e kanë realizuar sipas një plani të paracaktuar.

Bibliografia:

- 1) Dr. Mustafa Ceriç, "Besimi fetar, Populli, Atdheu. Feneri", Tiranë, 2004.
- 2) "100 ditët e Luftës në Kosovë – kronikë e ngjarjeve", Botim i AIITC, Tiranë, 1999.
- 3) "Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë", Botim i Bashkësisë Islame në Kosovë, Prishtinë 2000.
- 4) Dr. Rexhep Boja - myfti i Kosovës, "Për një jetë të nesërme më të mirë", Prishtinë, 2003.
- 5) Dr. Muhamed Pirraku, "Për kauzën e UÇK-së. Prishtinë, 2006,
- 6) Akademik Rexhep Ismaili, Kumtesë në simpoziumin ndërkombëtar "Religion und Kultur im albanischsprachigen Sudosteuropa", organizuar në Vjenë nga 10-12 mars 2008, nga Fondacioni PROORIENTE.